

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Shukri Sylejmani, kryetar, Isa Kelmendi dhe Emine Kaçiku, anëtarë, në çështjen juridike të paditësve Z. L., Sh. M., F. I., Gj. O., I. N. dhe R. N., e cila i përfaqëson paditësit tjerë, të gjithë nga ..., kundër të paditurve T., A. dhe M. (Zh.) N., të gjithë ..., për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur lidhur me revizionin e të paditurve T. dhe A. Nikqi, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1966/2014 datë 28.01.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 16.05.2019, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësve T. dhe A. N., nga Peja, i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1966/2014 datë 28.01.2019.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.1966/2014 datë 28.01.2019, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurve dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë C.nr.922/2007 datë 19.02.2014, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësve dhe janë detyruar të paditurit që në emër të kompensimit të dëmit për trungjet e prera (dru teknik) më datën 23.09.2007 në fshatin ..., Komuna ..., solidarisht t'iu paguajnë paditësve shumën prej 4.400 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë. Është refuzuar kërkesa e paditësve që të caktohet masa e përkohshme me të cilën iu ndalohet të paditurve që të disponojnë me masën e druve në sasi prej 55 m², të konfiskuara nga APK-Zyra në Pejë, t'iu ndalohet prerja e druve, dhënia e lejes për marrjen e druve teknik dhe për djegie dhe bartjen e tyre nga patundshmëria e shënuar në fletën poseduese nr..., ..., dhe ... në ..., gjer në përfundimin e plotfuqishëm të këtij kontesti. Për shpenzime procedurale është vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër aktgjyimit të gjykatës së shkallës së dytë, të paditurit Tahir dhe Asllan Nikqi, me kohë kanë paraqitur revizion për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që të prishen të dy aktgjykimet e lartpërmendura dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurë Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i të paditurve T. dhe A. N. është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit me të paditurit janë fëmijët e dy vëllezërve dhe se gjerë në vitin 1973 të njëjtit kanë jetuar në një bashkësi familjare. Me rastin e ndarjes së kësaj bashkësie, ndahet në mënyrë të barabartë edhe patundshmëria e tyre, si dhe kjo ndarje zyrtarizohet edhe në evidencat kadastrale , përjashtuar ngastrat sipas fletës poseduese nr.84 e cila evidentohet në emër të paraardhësit të paditurve por edhe kjo patundshmëri është pasuri e përbashkët e ndërgjyqësve dhe e ndarë në mes tyre. Më datën 23.09.2007, të paditurit në patundshmërinë e cila me rastin e ndarjes iu ka takuar paditësve dhe e cila evidentohet sipas fletës poseduese ..., ..., dhe ... ZK ..., kanë prerë 25 trungje druri e që masa bruto e këtyre druve është 35,738 m³.

Gjykata e shkallës së parë, faktet e lartpërmendura i ka vërtetuar në bazë të njoftimit të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencionit Pyjor të Kosovës, Zyra në Pejë, në të cilin është konstatuar se pas daljes në teren më datën 24.09.2007 së bashku me palët në procedurë është konstatuar se në patundshmërinë sipas fletave poseduese të lartpërmendura nuk është kryer damkosja e druve, ndërsa janë gjetur të prera 25 trungje masa drunore e të cilave është 35.738 m³. Faktin e ndarjes së patundshmërisë në mënyrën e përshkruar më lart, gjykata e shkallës së parë e vërteton në bazë të dëshmisë së dëshmitarit B. S. N., ndërsa faktin se trungjet janë prerë në pjesën e patundshmërisë që iu takon paditësve e dëshmojnë edhe i padituri M. N., dhe dëshmitari A. L., i cili është nip i ndërgjyqësve. Lartësinë e dëmit të shkaktuar gjykata e ka vërtetuar në bazë të ekspertizës të ekspertit të pylltarisë . Kërkesëpadinë e paditësve e njëjta gjykatë e ka aprovuar në pajtim me nenin 154, 155, 158 dhe 185 të LMD,

Gjykata e shkallës së dytë në procedurë ankimore, për të njëjta shkaqe dhe arsye të dhëna nga gjykata e shkallës së parë ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurve dhe ka vërtetuar aktgjykimin e të njëjtës gjykatë duke pranuar si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të dhëna në të njëjtin aktgjykim.

Në një gjendje të tillë faktike të vërtetuar kësisoj, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë dhe të dy të lidhur me aprovimin si të bazuar të kërkesëpadisë së paditësve, pasi që aktgjykimet e këtyre gjykatave nuk përfshihen me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe me zbatim të gabuar të së drejtës materiale në të cilat në kuptim të nenit 215 të LPK, gjykata e revizionit kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në revizionin e të paditurve vetëm në mënyrë të përgjithshme thuhet se aktgjykimeve e gjykatave përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pa u sqaruar konkretisht se cilat janë ato, andaj kjo gjykatë konstaton se janë të pabazuara thëniet në revizion përkitazi me shkeljet thelbësore të dispozitave procedurale.

Edhe sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, të paditurit në revizion nuk kanë përcaktuar se cila dispozitë ligjore e cilit ligj nuk është zbatuar apo se gabimisht është zbatuar, por në revizion theksojnë se faktet në të cilat është bazuar gjykata e shkallës së parë dhe e dytë janë të paqarta dhe kundërthënëse, nga se nuk janë sqaruar në mënyrë të duhur. Po ashtu kanë theksuar se njoftimi i lëshuar nga ministria e lartpërmendur nuk është i qartë sa i përket vendit dhe gjetjes së drunjëve të prerë, ndërsa deklarimi i të paditurit dhe i dëshmitarit A. L., se këto trungje janë prerë në pjesën e patundshmërisë së paditësve nuk mund të aprovet për arsye se i padituri M. N., ka deklaruar kështu vetëm për t'i bërë dëm vëllezërve-këtu të paditurve tjerë. Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se këto pretendime i përkasin gjendjes faktike për të cilën në kuptim të nenit 214.2 të LPK, nuk mund të paraqitet revizion. Megjithatë, Gjykata Supreme vlerëson se sa i përket kundërshtimeve të lartpërmendura gjykata e shkallës së parë dhe e dytë kanë dhënë arsye të qarta dhe bindëse të cilat janë të pranueshme edhe për gjykatën e revizionit. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të sigurt ka vërtetuar se të paditurit në pjesën e paditësve kanë prerë trungjet e lartpërmendura , po ashtu ka vërtetuar në mënyrë të sigurt sasinë drunore të prera dhe vlerën e tyre , kështu që në këtë aspekt pretendimet e të paditurve përkitazi me këto fakte vlerësohen si të pabazuara.

Për arsye se me pretendimet e revizionit nuk vihet në pyetje aktgjykimi i goditur me revizion, në kuptim të nenit 222 të LPK, revizioni i të paditurve T. dhe A. N., u refuzua si i pabazuar.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.143/2019 datë 16.05.2019

Kryetar i kolegjit,

Shukri Sylejmani